RAPORT GJYSMËVJETOR

PUNËN E GJYKATËS ADMINISTRATIVE RRETH VENDIMMARRJES NË RASTET QË KANË TË BËJNË ME TË DREJTAT SOCIALE

janar – qershor 2024



Financuar nga Bashkimi Evropian

Instituti për të drejtat e njeriut

Raport gjysmëvjetor mbi punën e gjykatës administrative rreth vendimmarrjes në rastet që kanë të bëjnë me të drejtat sociale

(Periudha: janar – qershor 2024)

Programi:

"Qasje në drejtësi për të gjithë – Programi vjetor i punës 2024" i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian

Zbatues:

Instituti për të drejtat e njeriut

Shkup, viti 2024

Ky raport është përpiluar me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij nuk pasqyron në asnjë mënyrë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

Hyrje 4

1. VËZHGIME NGA NDJEKJA E SEANCAVE PUBLIKE PARA GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT 5

1.1. Parimi i efikasitetit 5

1.2. Parimi i transparencës dhe llogaridhënies 7

1.3. Pjesëmarrja e palëve në procedurë 7

1.4. Detyrimi i vendimeve gjyqësore 9

2. GJETJE NGA MONITORIMI NË LIDHJE ME PROCEDURAT E KRYERA PARA ORGANEVE ADMINISTRATIVE 10

3. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E QASJES NË DREJTËSI PËR QYTETARTËT PARA GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË RMV-SË 11

HYRJE

Instituti për të drejtat e njeriut, nëpërmjet prezencës në seanca publike, rregullisht monitoron punën e Gjykatës Administrative. Qëllimi i këtij aktiviteti është që nëpërmjet vëzhgimit objektiv të punës së Gjykatës Administrative në trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me të drejtat sociale (të regjistruara në regjistrin gjyqësor nën U-4), të analizohet qasja në drejtësinë administrative për të gjithë qytetarët, me theks të veçantë ndaj grupeve të margjinalizuara dhe të cenueshme të qytetarëve (përfituesit e ndihmës sociale, prindërit vetëushqyes, personat me aftësi të kufizuara, romët, të moshuarit etj.). Ky aktivitet realizohet në kuadër të programit "Qasje në drejtësi për të gjithë"- Programi vjetor i punës 2024"[1], i mbështetur financiarisht nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, në kuadër të programit IPA III për shoqërinë civile dhe mediat, për vitin 2022.


Ky raport gjysmëvjetor është përgatitur duke mbledhur informacionet e mëposhtme:

1. Ndjekje e drejtpërdrejtë e seancave publike para Gjykatës Administrative në rastet që lidhen me të drejtat sociale;
2. Rishikim i vendimeve të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative dhe
3. Shqyrtimi i legjislacioni në lidhje me drejtësinë administrative dhe ushtrimin e të drejtave sociale.

Gjatë periudhës raportuese (janar – qershor 2024) janë vëzhguar gjithsej 63 seanca publike, me bazë të drejtat sociale. Si çështje më të shpeshta për të cilat diskutohej ishin: ushtrimi i të drejtave nga pensioni i pleqërisë, pensioni invalidor, shtesa prindërore për fëmijë, kompensimi për trajtim mjekësor jashtë vendit, ndihma e garantuar minimale etj.

Një pasqyrim i çështjeve më të pranishme është paraqitur në Tabelën 1.

Tabela 1: Numri i seancave publike sipas bazave të ndryshme



1 Programi "Qasje në drejtësi" i IDNJ-së - ***https://www.ihr.org.mk/mk/tekovni-proekti/pristap-do-pravda-za-site***

1.
VËZHGIME NGA NDJEKJA E SEANCAVE PUBLIKE PARA GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Deri në prill 2024, vetëm një këshill gjykues, i përbërë nga tre gjyqtarë, ka vepruar dhe vendosur në rastet që lidhen me të drejtat sociale. Me planin dhe organizimin e ri, si arsye e rritjes së numrit të rasteve dhe numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve, kryetari i Gjykatës Administrative ka caktuar tre këshilla që tashmë merren me raste të tjera në fusha të ndryshme, e që janë në kompetencë të Gjykatës Administrative, për të vendosur për rastet që kanë të bëjnë me të drejtat sociale të qytetarëve. Me një renditje të tillë, nuk do të ketë më një këshill të përbërë nga tre gjyqtarë, që vendos vetë në rastet që kanë për bazë të drejtat sociale të qytetarëve.

Ky vendim i kryetarit të Gjykatës Administrative në mënyrë legjitime ngre disa pyetje që i tangojnë qytetarët, në drejtim të veprimit profesional, efikas dhe në kohë në rastet që kanë të bëjnë me të drejta specifike të grupeve të margjinalizuara dhe të cenueshme të qytetarëve, sidomos duke marrë parasysh faktin se gjyqtarët, në tre këshillat e rinj, nuk kanë vendosur më parë në raste që u referohen të drejtave sociale, e ndërkaq kjo lëmi është shumë specifike, si nga pikëpamja ligjore ashtu dhe nga ajo procedurale.

1.1. PARIMI I EFIKASITETIT


Parimi i efikasitetit[2], në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), kërkon që procedura të zhvillohet në mënyrën më të thjeshtë të mundur, pa vonesa dhe me kosto sa më të vogël për palët. Në këtë periudhë raportuese, mund të konstatohet një shtyrje e shtuar e seancave të planifikuara publike, me kërkesë të njërës prej palëve (avokati i paditësit ose personi i interesuar). Në shumicën e seancave, arsyeja se pse avokatët e njërës prej palëve i shtynë seancat është për shkak të pranisë në seanca të tjera të planifikuara, me ç'rast janë evidentuar 20 shtyrje, përkatësisht 32% të 63 seancave të vëzhguara publike. Këto të dhëna janë shqetësuese, veçanërisht duke pasur parasysh se bëhet fjalë për paditës, të cilët si të ardhura të vetme monetare i kanë këto të drejta sociale, të cilat gjatë procedurës janë ndërprerë ose aspak nuk i kanë realizuar. Përveç kësaj, arsyeja e dytë më e madhe për shtyrjen e seancave publike është paraqitja jo në kohë ose e parealizuar e ftesës për seancën e caktuar nga "Posta maqedonase" deri te palët. Krahasuar me vitin paraprak, kjo gjë vazhdon të rrisë kostot e palëve, duke vonuar kështu vetë procedurën.

Gjithashtu, si rezultat i arsyeve të mësipërme për shtyrje të procedurës, në këtë periudhë raportuese mund të konstatohet se ende vazhdojnë të diskutohen raste në bazë të padive që janë ngritur në vitin 2022. Nga gjithsej 63 seanca publike, bazuar në të drejtat sociale, 5 ose 8% u referohen çështjeve nga viti 2022. Pjesa më e madhe e padive që janë diskutuar gjatë kësaj periudhe janë ngritur në vitin 2023. **Kjo mënyrë e veprimit nga ana e gjykatës nuk përputhet me Ligjin për kontestet administrative. Gjegjësisht, gjykata detyrohet të kryejë procedurën**

2 Neni 7 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.124/2015 dhe 65/2018

shpejt dhe të japë një vendim brenda një kohe të arsyeshme, jo më vonë se 9 muaj nga data e dorëzimit të akteve apo nga krijimi i kushteve për vendimmarrje pas padisë[3] Një pasqyrë e përmbledhur e rasteve të vëzhguara në bazë të padive është paraqitur në Tabelën nr. 2

Tabela nr.2: Viti i paraqitjes së padive të cilat janë diskutuar në këtë periudhë raportuese



Rrjedhimisht, **nëpërmjet vëzhgimit të seancave publike mund të vërtetohet se problemi i vonesës në seancat publike të planifikuara, pra mosrespektimi i datës së caktuar të gjykimit për shkak të vonesës me seancat e planifikuara paraprakisht, vazhdon të jetë problem** . Faktorët kryesorë që ndikojnë në vonesë janë menaxhimi jo i duhur i kohës së caktuar për seancat publike, si dhe mungesa e burimeve njerëzore, pra mungesa e stafit të gjykatës, të cilat janë thelbësore për kryerjen efikase të detyrave të punës. E gjithë kjo kontribuon në shtyrjen e datave të planifikuara për seancat publike gjatë gjithë ditës dhe në mbivendosjen e afateve. Ky problem duhet të zgjidhet sa më shpejt, për arsye se bëhet fjalë për qytetarë (paditës) të cilët, për shkak të specifikave të gjendjes së tyre shëndetësore, për shembull: invaliditeti, mosha etj, nuk janë në gjendje të presin më gjatë nga sa parashikohet për rastin e tyre dhe për këtë duhet t'u sigurohet qasje efektive në drejtësi dhe në gjykatë.

Në muajt prill dhe maj, për shkak të daljes në pension të njërit prej gjyqtarëve të këshillit të deriatëhershëm gjyqësor, si dhe për shkak të një renditje të re (riorientimi) të këshillave që vendosnin për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat sociale në Gjykatën Administrative, mund të vihet re se numri i gjykimeve ka rënë në mënyrë të theksuar. **Gjatë periudhës nga 26 prilli deri më 28 maj, sa u përket rasteve që kanë për bazë të drejtat sociale, nuk ishte caktuar asnjë rast për gjykim. Kjo është diçka shqetësuese, për arsye se bëhet fjalë për qytetarë që kanë raste që duhen zgjidhur sa më shpejt që të jetë e mundur dhe çdo vonesë në procedurë krijon rrethana rënduese shtesë për ta.**

Ky riorganizim i gjykatës duhet të përfundojë shumë më shpejt dhe në mënyrë efikase, që të mund të vazhdohet me gjykimet pa zvarritje të panevojshme. Përveç kësaj, procedura zvarritet edhe për shkak të ankesave të paraqitura nga gjyqtarët deri te Këshilli Gjyqësor në lidhje me riorganizimin e rasateve nëpër këshillat gjyqësorë, si pasojë e moskonsultimit të kryetarit të gjykatës me gjyqtarët lidhur me bazën mbi të cilën ata do të gjykojnë pasi të jetë bërë ky ndryshim. Në rastin konkret, nuk është respektuar dispozita e nenit 39 të Ligjit për Gjykatat, që parashikon se renditja e gjyqtarëve kryhet sipas Planit vjetor të punës, i cili përcaktohet nga Kryetari i Gjykatës, pas marrjes së mendimit në seancën e gjyqtarëve, gjegjësisht në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, duke pasur parasysh spe-

3 Neni 11 i Ligjit për Konteste Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.96/2019

cializimin e gjyqtarit për rastet penale, civile, ekonomike, administrative apo të fushave të tjera ligjore. Përveç kësaj, sipas të njëjtit nen, një gjyqtar nuk mund të transferohet nga një departament gjyqësor në tjetrin, kundër vullnetit të tij. [4]

Gjatë gjykimeve, të udhëhequra nga këshilli i ri gjyqësor, u konstatua se ekziston nevoja për të ndryshuar mënyrën e udhëheqjes me rastet "vizitë e fëmijëve". Gjegjësisht, në vend që ato të konsiderohen si të gjitha rastet e tjera, nevojitet të trajtohen si masa të përkohshme, me qëllim që të zgjidhen në një kohë sa më të shkurtër të mundshme, pasi bëhet fjalë për një diçka specifike, e cila është në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të fëmijëve.

1.2. PARIMI I TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES

Lidhur me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, mund të konstatohet se vazhdon të ketë publikim të rregullt të seancave publike të planifikuara në faqen e internetit të Gjykatës Administrative, në seksionin "Kalendari i gjykimeve"[5], me informacione të detajuara për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës publike, si dhe rastet të cilat do të gjykohen dhe nga cili gjykatës. Ky informacion është lehtësisht i disponueshëm për të gjithë qytetarët që janë të interesuar për kohën dhe vendin e seancës së tyre publike.

Sa i përket qëndrimit parimor të Gjykatës Supreme të RMV-së, datë 21.12.2022[6], i cili përcakton se "gjykatat duhet t'i publikojnë në faqen e internetit të Gjykatës vendimet e miratura (aktgjykimet dhe vendimet) që nuk janë në fuqi dhe që kanë të bëjnë me çështje të interesit publik", ai ende nuk zbatohet nga Gjykata Administrative, gjegjësisht në faqen e internetit publikohen vetëm vendimet që janë në fuqi, në seksionin "Vendime".[7] Procedura për gjetjen e rastit është gjithashtu lehtësisht e disponueshme dhe e kuptueshme, që përbën një rrethanë lehtësuese për palët gjatë kërkimit të vendimit për rastin e tyre.

Në seksionin "rreth Gjykatës"[8], në faqen e internetit të Gjykatës Administrative, mund të vihet re se, edhe pse tashmë janë ndryshuar bazat mbi të cilat gjykojnë të gjithë këshillat gjyqësorë, ato mbeten të pandryshuara në faqen e internetit, pra aty ende ndodhen të dhënat për gjyqtarët që kanë vlejtur para se të fillojë riorganizimi i këshillave gjyqësorë sipas bazave. Rrethana të tilla duhet të ndryshohen sa më shpejt që të jetë e mundur, për të mos shkaktuar konfuzion midis palëve në lidhje me atë se në çfarë baze bie e drejta e tyre, si dhe cilit gjykatës duhet t'i drejtohen në rast të problemeve apo pyetjeve që mund të kenë. Gjithashtu, ndodhen të dhënat e gjyqtares tashmë të pensionuar, Lidija Ivanovska, si dhe të dhëna të pasakta për numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve të punësuar në Gjykatën Administrative.

1.3. PJESËMARRJA E PALËVE NË PROCEDURË

Nga vëzhgimi i vazhdueshëm i seancave publike, mund të konstatohet se **organi i paditur e ka rritur mungesën e pranisë së tij në seancat publike të planifikuara (nga gjithsej 63 seanca**

4 Shih nenin 39, paragrafët 1 dhe 6 të Ligjit për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e RMV nr. 1658. 58/2006, 62/2006; 35/2008; 61/2008; 118/2008; 16/2009; 150/2010; 39/2012; 83/2018; 198/2018; 96/2019

5 Kalendari i gjykimeve - ***http://www.vsrm.mk/wps/portal/usskopje/sud/kalendar/!ut/p/z1/***

6 Qëndrimi parimor i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë datë 21.12.2022 : ***http://www.vsrm.mk/wps/wcm/connect/vsrm/6963e6e5-bab8-458c-acc2-f25717610f60/%D0%9D%D0%B0%D1%87%D0%B5%D0%BB%D0%B5%D0%BD%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%D0%B2 - %D0%BE%D0%B1%D1%D1%98%D0%D0%D0%D0%D0%D0%D0%D0%D0%D0%D0%D0%D0%D0%D0%D0%D0%B5%D0%BF%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%D0%D1%D0%D0%D0%B0%B8 %D0%BE%D0%B4%D0%BB%D1%83%D0%BA%D0%B8.pdf?_MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE._Z18_L8CC1J41L0B520APQFKICD0CU3-6963e6e5-bab8-458c-acc2-f25717610f60-lpacrVh***

7 Vendime - ***http://www.vsrm.mk/wps/portal/usskopje/sud/odluki/***

8 Për gjyqtarët - ***http://www.vsrm.mk/wps/portal/usskopje/sud/za-sudot/za-sudiite/***

publike të vëzhguara, organi i paditur ka marrë pjesë në vetëm 8 seanca publike apo në vetëm 12% të seancave të planifikuara). Në një pjesë të rasteve, kjo mungesë nuk është arsyetuar apo nuk është lajmëruar paraprakisht. Në këtë mënyrë **lihet tabloja e paplotë e rastit dhe barra i lihet gjykatës për të vlerësuar faktet dhe provat e paraqitura nga palët dhe paditësi, pa shtuar pretendimet dhe sugjerimet e oranit të paditur, duke e bërë kështu të pamundur respektimin e parimit të kundërthënies dhe barazisë së armëve në procedurë.** Organi i paditur dërgon rregullisht aktet, gjë e cila sipas LKA, është detyrim i tij. Megjithatë nga ana e gjykatësve ka pasur kritika për faktin se në gjykatë nuk janë dërguar të gjitha provat përkatëse që mund të kontribuojnë në mënyrë serioze për një aktgjykim më të qëndrueshëm. Gjithashtu, organi i paditur dërgon rregullisht përgjigje ndaj padisë, por në shumicën e rasteve, kjo përgjigje është e paplotë, e shkurtër dhe krejtësisht formale, pa një shpjegim të hollësishëm se cila është arsyeja e vendimit të kontestuar dhe mbi cilat fakte dhe prova është marrë ky vendim.

Organet e paditura më të përfaqësuara janë Ministria e Shëndetësisë, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale dhe Komisioni Shtetëror i Vendimmarrjes në Procedurën Administrative dhe Procedurën e Marrëdhënies së Punësimit në shkallë të dytë. Në Tabelën nr.3 pasqyrohet më qartë organi i paditur dhe numri i seancave publike ku ai ka qenë palë në procedurë.

Tabela 3: Organet e paditura para Gjykatës Administrative në rastet që kanë për bazë të drejtat sociale.

Organi i paditur	Numri i padive
Procedura Administrative Shtetërore dhe Procedura e Punësimit në Shkallën e Dytë	13
Ministria për Punë dhe Politikë Sociale	40
Ministria e Shëndetësisë	10

Duke qenë se paditësit në kontestet administrative shpesh herë janë përfitues të ndihmës sociale ose të papunë, një nga arsyet që ata nuk përfaqësohen nga një avokat prokurues mund të jetë paaftësia financiare për të paguar kostot e përfaqësimit. Arsyeja tjetër mund të lidhjet me atë se qytetarët nuk e njohin mirë Ligjin për ndihmën juridike falas dhe faktin se Ministria e Drejtësisë mund t'u miratojë atyre emërimin e një avokati për t'i përfaqësuar në një procedurë administrative ose kontest, nëse përmbushin kushtet e përcaktuara në Ligj.

Kjo qasje e gjyqtarëve është shumë për t'u vlerësuar, veçanërisht duke pasur parasysh se këta paditës nuk janë në gjendje të punësojnë një avokat përfaqësues, dhe se ata vetë nuk janë të njohur me procedurën e plotë për ushtrimin e së drejtës për të cilën kanë paraqitur kërkesë. Gjithashtu, në këtë mënyrë procedura e paditësve do të zgjasë shumë më pak, do të jetë më efikase dhe gjithçka do të rezultojë me një përfundim pozitiv.

1.4. DETYRIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE

Gjatë periudhës raportuese **është vënë re një numër i madh rastesh që kanë mbërritur në Gjykatën Administrative pas vlerësimit të tyre paraprak** , domethënë pas udhëzimeve të dhëna nga gjykata për ndryshimin e dokumenteve të kontestuara (nga gjithsej 63 seanca të vëzhguara publike, 20 seanca publike, ose 31% janë kthyer pas miratimit të tyre paraprak). **Problemi me këto lëndë të kthyera është fakti se disa prej tyre kanë të njëjtën përmbajtje me aktin e mëparshëm administrativ, i cili është anuluar nga Gjykata Administrative, dhe me udhëzime për ta ndryshuar atë, por organet publike kanë vepruar njësoj si më parë, madje dhe kanë miratuar një akt administrativ me të njëjtin vendim.** Sipas kësaj mund të konkludohet se organet publike nuk e respektojnë dispozitën e Ligjit për konteste administrative[9], i cili kërkon të plotësohet detyrimi për aktgjykimin në fuqi të gjykatës për palët në procedurë, përfshirë organet publike. Kjo gjë krijon një problem për qytetarët, të cilët përmes kësaj praktike detyrohen të kenë kosto më të mëdha dhe shtyrje të realizimit të së drejtës së tyre, gjë e cila mund të jetë thelbësore për përmirësimin e situatës në të cilën gjenden. Rrjedhimisht, organet publike, sidomos të këtyre fushave, duhet të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe efikase, si dhe t'i respektojnë udhëzimet e gjyqtarëve të parashikuara në vendimet e gjykatës, për t'i siguruar këtij grupi qytetarësh të drejtat që u takojnë me ligj.

9 Neni 13 i Ligjit për Konteste Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.96/2019 nga 17.05.2019

2.
GJETJE NGA MONITORIMI NË LIDHJE ME PROCEDURAT E KRYERA PARA ORGANEVE ADMINISTRATIVE

Gjatë vëzhgimit të seancave publike, mund të konstatohej se qytetarët problemin më të madh e kanë tek organet publike të shkallës së parë, të cilat ose nuk bashkëpunojnë me palët sa i përket procedurës në fjalë ose përpilojnë vendime krejtësisht të papërshtatshme që vazhdojnë të zvarriten për vite me radhë e të mbeten të pandryshuara edhe pas miratimit të vendimeve vlerësuese nga gjykata.

Ky problem ishte më i pranishëm te rastet që kanë për bazë ndihmën dhe kujtesin nga një person tjetër. Shumë prej paditësve, gjatë kësaj periudhe raportuese, kanë treguar se kanë hasur një problem të madh gjatë bashkëpunimit me zyrtarët e organeve shtetërore, si dhe me mospranimin e dokumentacionit të tyre, që është pjesë thelbësore e vetë procedurës, për ushtrimin e kësaj të drejte. Disa nga paditësit gjithashtu janë ankuar se zyrtarët e organeve shtetërore u kanë kërkuar të nënshkruajnë deklarata boshe, duke u thënë se me këtë deklaratë e kanë të sigurt fitimin e të drejtës së dëshiruar. Ky qëndrim jo i duhur i zyrtarëve bën që qytetarët, të cilët kanë më së shumti nevojë për këtë ndihmë, të mos jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre dhe procedura të vazhdojë të sorrollatet nëpër labirintet e organeve shtetërore dhe gjykatave.

Arsyeja më e shpeshtë për të cilën janë paraqitur kërkesa gjatë kësaj periudhe raportuese është shtesa prindërore. Në lidhje me këto raste, zakonisht palët nuk janë të njoftuar me procedurën, gjegjësisht me dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm për ushtrimin e kësaj të drejte. Gjëja që paditësit njohin më së paku është dorëzimi i vërtetimit se bëhet fjalë për nxënës të rregullt, vërtetim që duhet t'i dorëzohet organit shtetëror më së voni deri më 30 shtator, për vitin në të cilin regjistrohet fëmija (nxënësi). Gjithashtu duhet theksuar se organi i paditur nuk i udhëzon palët, të cilat për shkak të situatës së tyre nuk janë në gjendje të angazhojnë përfaqësues të vetin, në lidhje me afatet për dorëzimin e dokumenteve të nevojshme, si dhe për atë se cilat dokumente duhet të dorëzohen. Veç kësaj, paditësit janë ankuar se zyrtarët kanë marrë vendime në bazë të dokumenteve që fare nuk janë dorëzuar nga ana e tyre, si dhe vendimeve që nuk kanë figuruar fare në qarkullimin ligjor. Të gjitha këto probleme bëjnë që paditësit, që kanë nevojë për ndërhyrje urgjente, të detyrohen të presin vendime nga gjykata që ndoshta do të miratohen një vit pas fillimit të procedurës.

Në këtë periudhë raportuese është konstatuar se shumica e paditësve ose avokatët e tyre prokurues i paguajnë tatimet gjyqësore, **të cilat, sipas nenit 11 të Ligjit për Tatimet Gjyqësore, nuk janë të detyrueshme për t'u paguar për të drejtat sociale, gjëgjësisht rastet sociale përjashtohen nga tatimet gjyqësore.** Këtu parashtrohet pyetja: Pse palët, gjatë ngritjes së padisë, nuk informohen nga administrata e gjykatës se këto raste nuk duhet të paraqiten, domethënë se nuk duhet të paguhen tatimet gjyqësore. Njëkohësisht parashtrohet edhe pyetja se pse avokatët nuk janë të informuar për çlirimin nga tatimet gjyqësore në këto baza, megjithëse janë të detyruar të dinë, duke i ekspozuar kështu palët në shpenzime të panevojshme!?

3.
REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E QASJES NË DREJTËSI PËR QYTETARTËT PARA GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË RMV-SË

- Respektimi dhe zbatimi i udhëzimeve të dhëna nga Gjykata Administrative për mënyrën se si duhet të vijojnë së vepruari organet publike pas shfuqizimit të një akti administrativ;
- Përmirësimi i qasjes së nëpunësve civilë ndaj palëve, gjegjësisht profesionalizmi dhe efektiviteti i tyre në bashkëpunim me palët, me qëllim arritjen e një zgjidhjeje e cila është në kohë, e mbështetur ligjërisht dhe realiste;
- Respektimi i parimit të orientimit të shërbimeve të organeve publike, duke mundësuar qasje më të lehtë dhe më efektive në drejtësi për të gjithë qytetarët;
- Përforcim i kuadrove të administratës gjyqësore (daktilografistë, asistentë profesionistë, arkiva) sa më shpejt të jetë e mundur, me qëllim zhvillimin sa më efikas të seancave publike;
- Zbatimi dhe respektimi i dispozitave të LPPA-së dhe LKA-së nga ana e avokatëve gjatë përfaqësimit në seanca publike, duke përfshirë sigurimin e qasjes në të gjitha dokumentet me të cilat disponojnë organet shtetërore.
- Respektimi i parimit të zhvillimit të një diskutimi efektiv gojor (menaxhimi i duhur i kohës dhe rrjedhës së seancës);
- Njoftim i palëve të administratës gjyqësore kur paraqesin padi (në arkiv dhe sportel të hyrjes) për përjashtimin nga pagesa e tatimeve gjyqësore për rastet sociale;
- Prania e organit të paditur në seancat publike, me qëllim që të respektohet parimi i kundërthënies në seancën publike;
- Zbatimi praktik i parimit të orientimit të shërbimeve të organeve publike dhe familjarizimi i qytetarëve me procedurën dhe dokumentet e nevojshme për realizimin e të drejtave sociale;

